

Në bazë të nenit 35, paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77 / 16 gusht 2010), dhe neneve 7, 8, 9, dhe 85 të Ligjit nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore i Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datë 30 prill 2020 miratoi këtë:

RREGULLORE PËR LICENCIMIN E BANKAVE DHE DEGËVE TË BANKAVE TË HUAJA

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo rregullore përcakton kushtet, kërkesat, procedurat dhe afatet që duhet ndjekur për aplikimin dhe dhënien e një licence për një bankë dhe/apo për një degë të një banke të huaj;
2. Kjo rregullore do të zbatohet për të gjithë aplikuesit për licencë nga BQK-ja për t'u angazhuar në veprimtarin bankare në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha termet në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e definuar në nenin 3 të Ligjit nr.04/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jo bankare (në vijim: Ligji për bankat) ose / dhe me përkufizimet si më poshtë për qëllimin e kësaj rregulloreje:
 - 1.1. **Bankë** - do të thotë një shoqëri aksionare e angazhuar në veprimtari bankare, duke përfshirë një subjekt të varur;
 - 1.2. **Degë e një banke të huaj** - është një person i organizuar dhe i licencuar nga BQK-ja, për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Kosovës, por banka-amëe të cilës ka selinë e vet kryesore dhe mban licencë për të ushtruar veprimtari bankare në një juridiksion tjetër jashtë Republikës së Kosovës.
 - 1.3. **Pronari përfitues** - do të thotë çdo individ apo grup i individëve të cilët direkt ose indirekt kanë në posedim ose beneficione nga pronësia e pasurisë, megjithëse pronësia është në emër të entitetit tjetër.

Neni 3

Kërkesat për aplikim

1. Të interesuarit për licencë bankare duhet të përmbushin të gjitha kërkesat sipas Ligjit për bankat, që janë të nevojshme për procesin e aplikimit sipas akteve të brendshme të BQK-së. Aplikuesi mund të kërkojë format e nevojshme të aplikimit dhe udhëzimet për plotësimin e tyre nga BQK-ja apo të njëjtat mund t'i gjejë në webfaqen zyrtare të BQK-së.
2. Aplikacioni nënshkruhet nga të gjithë aksionarët themelues dhe dorëzohet në BQK, me prezencë fizike të përfaqësuesve të aksionarëve themelues të bankës së propozuar ose të bankës së huaj në rastet kur ato janë të interesuara për hapjen e një degë në Kosovë. Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentacionin e plotë që kërkohet me Ligjin për bankat dhe me këtë Rregullore.
3. Dokumentacioni i ofruar duhet të jetë në një nga dy gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, qoftë në origjinal ose në kopje të legalizuar. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet kompetente të një shteti të huaj, dokumentacioni duhet të jetë i legalizuar nga autoritetet përgjegjëse të atij shteti të huaj dhe në përputhje me dispozitat e akteve ligjore përkatëse të ligjeve të tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 4

Kërkesat e kapitalit për licencim

1. Aplikuesi për licencë bankare për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Kosovës gjatë procesit të themelimit dhe para marrjes së licencës përfundimtare, duhet të depozitojë për këtë qëllim në BQK një kapital fillestar minimal në shumë jo më pak se 7 milionë Euro, në pajtueshmëri me kërkesa e nenit 15 të Ligjit për bankat.
2. Banka e huaj që aplikon për të kryer veprimtari bankare përmes degës së saj, duhet të mbajë në BQK një depozitë në barasvlerën e kapitalit, jo më pak se 7 milionë Euro siç është përcaktuar me nenin 17 të Ligjit për bankat.
3. Për një bankë apo degë të një banke të huaj pagesat ose shpenzimet për blerjen ose për qiramarrjen e lokaleve të punës dhe pajisjeve, si dhe shpenzimet e tjera operative nuk do të përfshihen në shumën e kapitalit fillestar minimal ose shumën minimale të depozitës në barasvlerën e kapitalit, të kërkuara në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 5

Drejtorët dhe menaxherët e lartë

Kriteret standarde për drejtorët dhe menaxherët e lartë të propozuar gjatë procesit të licencimit për një bankë apo degë të një banke të huaj në Republikën e Kosovës janë të paraqitura në nenin 3 dhe nenin 4 të Rregullores së BQK-së për drejtorët dhe menaxherët e lartë të bankave.

Neni 6

Përshtatshmëria e aksionarëve

1. BQK-ja vlerëson përshtatshmërinë e aksionarëve kryesorë potencial, në lidhje me një aplikacion të ri për licencë bankare sipas kërkesave të nenit 7 të Ligjit për bankat. Gjatë procesit të aplikimit, aplikuesi duhet të shpalosë listën e të gjithë aksionarëve themelues si dhe pronarëve përfitues, në rastet kur janë të ndryshëm. Burimet e fondeve të investuara në bankë nga ana e aksionarëve duhet të shpalosen për BQK-në në të gjitha rastet.
2. Çdo aksionar i potencial duhet të jetë në gjendje të demonstrojë qëndrueshmëri financiare. Kjo përfshin dëshmi të përmbushjes së shpejtë të detyrimeve financiare të kaluara dhe një gjendje ekzistuese të shëndoshë financiare. Aksionari potencial duhet të dorëzojë dokumentacionin valid, që vërteton pagesën e të gjitha detyrimeve fiskale, dokumenti i tillë duhet të jetë i lëshuar jo më vonë se 30 ditë nga data e aplikimit.
3. BQK-ja do të verifikojë në mënyrë të pavarur, personat që kontrollojnë bankat ose që janë propozuar t'i kontrollojë. Ky autorizim përfshin mbledhjen e dëshmive dhe dokumenteve në procedurat formale sipas procedurave administrative përkatëse.
4. Këto janë kërkesa të vazhdueshme dhe kërkesa të ngjashme do të aplikohen kur banka njofton BQK-në sipas nenit 37 të Ligjit për bankat për një aksionar potencial të ri apo kur një aksionar ekzistues dëshiron që të rritë aksionet e tij mbi ndonjë nga kufijtë e përcaktuar në nenin 37 të Ligjit për bankat.
5. BQK-ja do të vlerësojë, sipas nenit 8 të Ligjit për bankat, strukturën e pronësisë së një banke potenciale si tërësi, si dhe përshtatshmërisë individuale të aksionarëve, në mënyrë që të sigurojë se struktura e pronësisë nuk do të pengojë mbikëqyrjen efektive të bankës.

Neni 7

Degët e bankave të huaja

1. Kur një bankë e huaj aplikon për themelimin e një dege në Kosovë, kushtet do të jenë të njëjta si për bankat vendase. BQK-ja do të vlerësojë qëndrueshmërinë e aksionarëve dhe të grupit si tërësi, veçanërisht kur banka amë nuk është banka kryesore në grup. Por përveç kësaj, siç kërkohet me nenin 7 të Ligjit për bankat, BQK-ja do të kërkojë dëshmi që vërteton se mbikëqyrësi i bankës amë nuk ka ndonjë kundërshtim ndaj një propozimi të këtillë. BQK-ja gjithashtu paraprakisht duhet të bindet që grupi bankar, pjesë e të cilit do të jetë banka e re, është subjekt i mbikëqyrjes së konsoliduar efektive.
2. Në rastet kur banka e huaj aplikon për licencë për themelimin e degës së saj në Kosovë, BQK-ja kërkon nga autoriteti mbikëqyrës i juridiksionit të bankës amë:
 - 2.1. një dëshmi që vërteton se aplikuesi është institucion i organizuar mirë dhe posedon licencë valide të institucionit për marrjen e depozitave;
 - 2.2. një informim shtesë rreth ekzaminimit të fundit të bankës amë brenda njëqind e tetëdhjetë (180) ditëve të fundit, që tregon se niveli i kapitalit, kualiteti i mjeteve dhe raportet e

likuiditetit janë të vlerësuara nga ky autoritet së paku me klasifikim të nivelit të kënaqshëm;

2.3. se aplikuesi nuk është objekt i masave përmirësuese apo nën ndonjë program të mbikëqyrjes me paralajmërim të hershëm të caktuar nga autoriteti mbikëqyrës;

2.4. se themelimi i degës dhe aktivitetet e saj në Kosovë janë të lejuara pa ndonjë kusht të paracaktuar;

3. Në rastet e kërkesave për licencë për degë të bankave të huaja do të kërkohet edhe një letër sigurie e adresuar për BQK-në nga banka e huaj amë, me anë të së cilës njihet detyrimi ligjor i bankës së huaj për pagesën e të gjitha obligimeve të degës së bankës së huaj në Kosovë.
4. Neni 17 i Ligjit për bankat i kërkon çdo banke të huaj që operon me një apo më shumë degë në Kosovë, që t'i mbajë kërkesat ndaj banorëve të Kosovës më të larta sesa detyrimet e saj ndaj banorëve të Kosovës. BQK-ja përcakton nivelin e lartësisë së kërkesave mbi detyrimet ndaj banorëve të Kosovës varësisht nga vlerësimi i degës në baza individuale.
5. BQK-ja ka të drejtën për t'i kërkuar një banke të huaj që vepron përmes një dege të saj në Kosovë që të kthejë degën e saj në subjekt të varur në pajtueshmëri me nenin 12 të Ligjit për bankat.
6. Nëse sipas vlerësimit të BQK-së dega e bankës së huaj është duke vepruar në kundërshtim me interesat e depozitorëve të saj, BQK-ja ka të drejtën e tërheqjes së licencës së bankës së huaj për të vepruar si degë dhe bllokimin e depozitës ekuivalente me kapitalin.
7. Në rastet kur një bankë e huaj themelon dy apo më shumë degë në Kosovë, një nga degët duhet të caktohet si qendra kryesore administrative e bankës. Raportet rregullative do të dërgohen në BQK të konsoliduara, duke përfshirë të gjitha të dhënat e degëve të bankës së huaj në Kosovë.

Neni 8

Miratimi paraprak apo refuzimi i dhënies së licencës

1. BQK-ja vlerëson dhe rishikon aplikacionin e dorëzuar dhe dokumentacionin e kërkuar për marrjen e licencës, në pajtueshmëri me kërkesat e paraqitura në Ligjin për bankat dhe me këtë Rregullore.
2. Në pajtim me nenin 8 të Ligjit për bankat, BQK brenda 3 muajve nga data e pranimit të kërkesës së kompletuar për licencë paraprakisht miraton ose refuzon atë dhe njofton me shkrim paraqitësin e kërkesës për vendimin e saj. Njoftimi për refuzim të licencës duhet të cekë arsyet mbi bazë të së cilave është refuzuar licenca.
3. Në kuadër të periudhës prej 3 muajve për vendosje lidhur me kërkesën për licencë siç është përcaktuar në paragrafi 2 të këtij neni, përfshihet edhe periudha e shfrytëzuar për çështje procedurale për vendimmarrje nga ana e Bordit Ekzekutiv.
4. Për qëllim të paragrafit 2 të këtij neni, data e pranimit të kërkesës për licencë, konsiderohet si datë e pranimit të kërkesës së kompletuar.

5. BQK-ja mund të kërkojë ndryshimin e emrit të propozuar të bankës, po që se parasheh mundësinë që një emër i tillë do të krijojë konfuzitet për publikun apo për sistemin bankar.
6. Pas pranimit të kërkesës për licencë, BQK-ja kryen operacionet e paraqitura në vijim:
 - 6.1. rishikon informacionin e plotë të siguruar përmes dokumentacionit të dorëzuar dhe kryen verifikimet plotësuese sipas nevojës;
 - 6.2. nëse vlerësohet e arsyeshme, mund të organizojë dhe të mbajë mbledhje me drejtorët e propozuar të bankës ose menaxherët e lartë, në rastet e degëve të bankave të huaja, dhe/ose aksionarët themelues të bankës apo përfaqësuesit ligjor të bankës së huaj (në rastet kur aplikacioni i dorëzuar lidhet me licencimin e një dege të ndonjë banke të huaj).
7. Qëllimi i organizimit dhe mbajtjes së këtyre mbledhjeve është diskutimi i strategjisë së tregut dhe objektivat e tyre, i planit të parashikuar të biznesit, politikave kryesore të propozuara dhe rreziqeve që mbart banka apo dega e bankës së huaj për tregun, si dhe çështjeve të tjera relevante që mund t'i identifikojë si të nevojshme BQK-ja.

Neni 9

Njoftimi për faktet e reja

1. Aplikuesi për licencë njofton me shkrim BQK-në për faktet ose rrethanat e reja të krijuara pas dhënies së miratimit paraprak për licencë, si dhe ndryshimet që ato sjellin në dokumentacionin e paraqitur, mbi bazën e të cilit BQK-ja ka dhënë miratimin paraprak për licencë.
2. Njoftimi sipas paragrafit 1 të këtij neni bëhet menjëherë, por jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas paraqitjes së rrethanave të reja të aplikuesit.

Neni 10

Licenca përfundimtare

1. Banka që merr miratimin paraprak për licencë, pasi plotëson kushtet siç janë paraqitur në nenin 8, paragrafi 5, i Ligjit për bankat, duhet të aplikojë me shkrim në BQK për marrjen e licencës përfundimtare, duke paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm:
 - 1.1. dokumentin bankar që vërteton pagimin e shumës së kapitalit fillestar minimal apo transferimin e shumës së depozitës ekuivalente me kapitalin për degët e bankave të huaja, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 15 dhe nenin 17 të Ligjit për bankat;
 - 1.2. regjistrimin e biznesit si person juridik ose të regjistrimit të degës së bankës së huaj në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë;
 - 1.3. aktet nënligjore / statuti i bankës;
 - 1.4. dokument valid për fitimin e të drejtës së përdorimit të ambienteve ku do të zhvillohet veprimtaria bankare dhe financiare. Lokalet duhet të jenë të legalizuara dhe të kenë dokumentacionin e duhur nga autoritetet kompetente;

- 1.5. kontratat përkatëse me kompanitë e sigurimit, lidhur me sigurimin ndaj rreziqeve kryesore (zjarri, tërmeti, vërshimeve) të objekteve dhe pajisjeve, me ndonjërin nga kompanitë e sigurimit të licencuara nga BQK-ja;
 - 1.6. kontratat për mbrojtjen e ambienteve dhe pajisjeve nga kompanitë e mbrojtjes dhe të sigurisë fizike të licencuara nga organi kompetent në Republikën e Kosovës;
 - 1.7. Kontratat përkatëse me kompanitë e sigurimit për sigurimin e parasë së gatshme në trezor dhe paratë e gatshme në lëvizje, që banka duhet t'i mbajë gjatë aktivitetit të saj.
2. BQK, para miratimit të licencës kryen një ekzaminim në vend, të kushteve teknike dhe të sigurisë së ambienteve në të cilat aplikuesi (banka ose dega e bankës së huaj)do të zhvillojë veprimtarinë bankare. Qëllimi i këtij ekzaminimi është të vlerësojë nëse subjekti në fjalë ka krijuar kushte për të përmbushur detyrimet e përcaktuara me kushtet teknike dhe të sigurisë së ambienteve në të cilat subjekti do të zhvillojë veprimtarinë.
 3. Nëse BQK-ja konstaton se kushtet në këtë nen janë përmbushur, do të lëshojë licencën siç përcaktohet me nenin 9 të Ligjit për bankat.

Neni 11 **Dënimet penale**

Kryerja e veprimtarive bankare pa posedim të licencës bankare dhe paraqitja e informatave të falsifikuara dhe të rrejshme lidhur me aplikacionin për licencë konsiderohet si vepër penale sipas nenit 84 të Ligjit për bankat dhe janë subjekt i dënimeve penale.

Neni 12 **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për Licencimin e Bankave dhe Degëve të Bankave të Huaja, e miratuar nga Bordi i BQK-së më 09 nëntor 2012 dhe çdo dispozitë tjetër që mund të jetë në kundërshtim me këtë rregullore.

Neni 13 **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë nga miratimi i saj dhe vlen për aplikacionet e pranuar pas hyrjes në fuqi të kësaj rregullore.

Flamur Mrasori

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës